

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 30 TETOR 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 32

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 32

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Nënkryetari i Bashkisë dhe Drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak materialet dhe rendi i ditës u janë shpërndarë këshilltarëve, kush është dakort me rendin e ditës?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 32 këshilltarë, 32 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

MBI VËRTETIMIN E MANDATEVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT ZNJ.MIRELA QELESHI DHE Z.SANJEL SKËNDERAS”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këshilltarët të cilët zvëndësojnë vendet bosh, znj.Mirela Qeleshi dhe z.Sanjel Skënderas, ju lutem komisioni i mandateve.

Këshilltar E.Muharrem: Faleminderit znj.Kryetare, përshëndetje gjithë kolegëve, komisioni i verifikimit të mandateve po ju raporton si më poshtë të dyja vendimet e komisionit qendror të zgjedhjeve:

Është vendimi nr.13/ 77 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve datë 22.09.2025 për plotësimin e vakancave në Këshillin Bashkiak nga lista e kandidatëve të Koalicionit Bashkë Fitojmë znj.Mirela Thoma Qeleshi. Njëkohësisht edhe vendimi nr. 1400 datë 9.10.2025 për plotësimin e vakancave në Këshillin Bashkiak Korçë me kandidatë nga lista shumë emërore e Koalicionit Bashkë Fitojmë z.Sanjel Edmond Skënderas nga verifikimi i dokumentacionit, komisioni verifikon se mandatet janë fituar komfort kërkesave të

komisionit zgjedhor dhe ligjit 89/2015 për vetëqeverisjen vendore ndaj ftoj gjithë këshilltarët që të miratojnë këtë raport.

Këshilltar E.Bregu: Kam diçka, duke pasur parasysh faktin se këto mandate janë konfirmuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve që janë fituar në mënyrë të ligjshme, nuk po marrim në konsideratë të nuk po marrim në konsideratë të diskutojmë për anën ligjore po e quajmë të mirëqënë por kemi parasysh faktin se këshilltari Sanjel Skënderasi zvëndëson këshilltarin Fidel Kreka i cili është pjesë e grupimit Bashkë Fitojmë dhe është pjesë e Këshillit nga votat e demokratëve. Ndërkohë sot jemi para faktit publik që Sanjel Skënderas është anëtar i Partisë Socialiste, këtu ne shohim një devijim të vullnetit të zgjedhësve, meqënëse nga ana ligjore ai ka të drejtë ta marrë mandatin mos ndoshta do ishte e moralshme që ai mos e pranonte mandatin?

Sepse nuk përfaqëson vullnetin e zgjedhësve që e kanë zgjedhur në këtë rast, kjo ishte pyetja që kam.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit përderisa Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve e njeh komfort ligjit që z.Sanjel Skënderasi do jetë anëtar i Këshillit Bashkiak si këshilltar i rradhës është në të drejtën e z.Skenderasi të zgjedhë se në cilin grupim politik do vazhdojë të ushtrojë detyrën e tij si këshilltar.

Këshilltar E.Bregu: Ai e ka zgjedhur paraprakisht para shumë kohësh nuk mund ta zgjedhë tani.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk jemi ne ata të cilët vendosim se çfarë do bëjë z.Skënderasi. Do doja së pari ta hedhim në votim, po i hedh me rradhë, kush është dakort për znj.Mirela Qeleshi?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 32 këshilltarë, 32 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort për z.Sanjel Skënderasi për të qënë pjesë e Këshillit?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 32 këshilltarë, 26 pro, 5 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem sekretaria, të kujdeset për betimin.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Pati të lexoj formulën e betimit ju do thoni betohem. Betohem në nderin tim se do kryej me ndërgjegjie detyrën si anëtar i Këshillit Bashkiak, do i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, betohem se në gjithë veprimtarinë time do udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Korçë dhe do punoj me ndershmëri, përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre.

Këshilltare M.Qeleshi: Betohem.

Këshilltar S.Skënderasi: Beto hem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Suksese dy këshilltarëve të rinj, kalojmë tek pika e 3.

Pika 3 e rendit të ditës.

“PËR CAKTIMIN E KËSHILLTARËVE ZNJ.MIRELA QELESHI DHE Z.SANJEL SKËNDERAS NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në dijeninë time komisioni nuk është mbledhur, unë do doja që së pari sekretaria të na informojë mbi mënyrën sesi vendosen këshilltarët në komisione kur zvëndësojnë këshilltarët e larguar dhe së dyti nëse dikush nga ju ka ndonjë mendim për të diskutuar lidhur me këtë çështje e ka fjalën më pas.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Si rregull në rregulloren e Këshillit Bashkiak për organizimin dhe funksionimin e Këshillit, në seksionin nr.2, komisionet e Këshillit, neni 33, pika 10 thuhet këshilltari i ri i cili zvëndëson një këshilltar të larguar si rregull është pjesë e komisioneve ku ka qënë këshilltari i zvëndësuar. Znj.Mirela Qeleshi e cila ka zvëndësuar këshilltaren e larguar znj.Ismeralda Seidolli do jetë pjesë e komisionit të rregullores, çështjeve ligjore dhe administrative të Bashkisë, komisionit të buqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujrave dhe mbrojtjes, mjedistet e biodiversitetit dhe komisioni për titujt e nderit. Z.Sanjel Skënderasi i cili ka zvëndësuar këshilltarin e larguar z.Fidel Kreka do jetë pjesë e komisionit të sigurisë publike, emergjencave civile dhe rehabilitimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka diçka nga këshilltarët, kush e do fjalën?

Këshilltar D.Osmeni: Në lidhje me komisionet, në lidhje me rregulloren sipas asaj që lexoi dhe znj.sekretare, këshilltarët të cilët zvëndësojnë një këshilltar të larguar, e para secili nga ne ka përfaqësimin e tij dhe nuk do të thotë se një këshilltar që ka ikur ka të njëjtën përvojë apo eksperiencë apo profil pune, të njëjtë me atë që po zvëndëson dhe kjo nuk është normale që ne të miratojmë nëpër komisione sepse kur i kemi vënë në fillim kemi menduar si opozitë apo mazhorancë që kemi vendosur personat e duhur sipas profilit edhe në rastin në fjalë nuk mundet që ne ta pranojmë këtë, unë të kam çuar një email në lidhje me rastin e znj.Qeleshi të cilën ju duhet ta përfshini tek komisioni që ne kemi kërkuar si grup. E dyta bie ndesh sepse në komisionin që z.Skënderasi do zvëndësojë z.Kreka, ashtu siç e tha edhe kolegu parafolës Elvini dhe ai nuk më përfaqëson forcën tonë politike dhe nuk mundet që ju të keni një komision të përbërë nga Partia Socialiste, kështu që të dy këto komisionet duhet të diskutohen. Nga diskutimet që kam bërë me kryetaren e Këshillit më është thënë se komisionet kanë një numër të caktuar anëtarësh dhe këtu bie dakort të jetë një vendimmarrje noramlisht kujt i takon shumica, por para se të kaloj në propozimi im për pjesën e komisioneve do doja të dëgjoja nga sekretaria si do procedohet me këto dy pyetje që unë kam. Faleminderit.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Duke qënëse ne jemi në mes të një mandati për këtë arsye rregullorja e Këshillit Bashkiak e ka parashikuar edhe këtë pjesë sesi pozicionohen këshilltarët nëpër komisione ju

mund të thoni propozimet tuaja dhe kryetaria t'i hedhë në votim edhe komisionet në fillim me votim janë ngritur.

Këshilltar D.Osmani: Tani në lidhje me komisionin që përfaqëson z.Skënderasi do e mbani ju të gjithën sepse ne nuk kemi përfaqësues.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk e di nëse z.Skënderasi ka vendosur të jetë pjesë e grupit tonë opozitar.

Këshilltar D.Osmani: Ja po ta them unë si kryetar i grupit opozitar, nuk kam erdhur me mendjen time.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos e ngrini zërin, ta dëgjojmë z.Skënderasi.

Këshilltar D.Osmani: Z.Skënderasi ka të drejtën e tij të flasë, të shprehet por ju duhet të më dëgjoni mua si kryetar i grupit opozitar, ne atë komision ne jemi pa përfaqësues, nuk ka nevojë që ju ta komentoni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos hamendësoni, fjala për ju z.Skënderas.

Këshilltar S.Skënderasi: Përshëndetje, si fjala ime e parë në Këshill doja të theksoja diçka në lidhje me vendimet politike që unë do të marr me forcën që përfaqësoj, dua t'i kthej përgjigje z.Bregu dhe z.Osmani se unë kam qënë ai që këta kanë dalë këshilltarë me firmën dhe vulën time dhe kë krah politik do mbaj unë më takon mua, z.Osmani le ta zgjidhë me partinë e vet që do që ta përfaqësojë, unë për veten time kam bërë zgjidhjet e mia jam i lirë dhe nuk besoj se i prish punë ndonjërit prej tyre, t'ju kthej ndonjë përgjigje tjetër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër?

Këshilltar D.Osmani: Ka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos ndërhyini unë thash ka diçka tjetër dhe ka të tjerë këshilltarë që duan fjalë, do ja u jap e ju.

Këshilltar D.Osmani: Duhet të flas njëherë unë pasi është interesi im personal dhe unë përfaqësoj Koalicionin Bashkë Fitojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos bërtisni, fjala nuk merret kërkohet, fjala për ju në lidhje me komentin që bëri z.Skënderasi.

Këshilltar D.Osmani: Nuk kam asnjë koment me këshilltarin sepse është e drejta e tij përfaqëson që do ai por ne si grup opozitar në atë komision nuk kemi asnjë përfaqësues dhe kjo është pjesë e asaj që ju po e bëni kaq problematikë sepse dhe kur kemi ngritur komisionet para dy vitesh jemi dakortësuar me z.Tollkuçi i ndamë sipas asaj që përcakton rregullorja sa i takojnë opozitës, sa mazhorancës dhe nuk kemi bërë asnjë debat, po them nuk kemi përfaqësim tek ai komision ju lutem ose dikush nga ju të na japë një zgjidhje ose të japim ne një emër dhe ju zvëndësojeni me një emrin tuaj që ne të kemi përfaqësim. E dyta ju thatë se numri në komision nuk ndryshon dhe përderisa nuk ndryshon në këtë komision do duhet të kemi përfaqësuesin tonë, në komisionin e emergjencave ishte Fideli, nesër do vijë dikush nga ju do kalojë nga ne nuk kam gjë me këshilltarin, nuk gjykoj njeri, ne nuk mund të jemi pa përfaqësim në komision zgjidheni ju. E treta duke qënë se znj.Mirela nuk është e përshtatshme për ato komisione që ka qënë zonja që është larguar dhe nuk e di pse ju nuk e doni znj.Mirela atje ku unë e kam propozuar, unë po ju kërkoj si këshilltar dhe kryetar i komisionit të financave, do jap dorëheqjen dhe propozoj se në vendin tim të shkojë znj.Qeleshi dhe të vazhdojmë mbledhjen pa asnjë debat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Një këshillë nga ana ime, më vjen keq që po tërhiqeni ju si financier nga një komision ku ju keni dhënë kontributin tuaj, megjithatë kjo është zgjedhje personale, personalisht do doja që ju ta ushtronit detyrën tuaj tek ai komision. E dyta doja t'ju kujtoja gjithë këshilltarëve pavarësisht se ne kemi formatuar komisione, para mbledhjeve të këshillit çdo këshilltar që do të marrë informacion në komisione të caktuara është i lutur të vijë të marrë pjesë, t'i drejtojë pyetje ekzekutivëve të marrë informacionin e nevojshëm dhe më pas në mbledhjet e Këshillit ai është një zë i fuqishëm dhe zëri i tij më pas është e vendimmarrjes.

Këshilltar P.tollkuçi: Përhëndetje të gjithëve, si fillim dua të uroj suksese dy këshilltarët e rinj për detyrën e sapo marrë, unë si drejtues i grupit socialist mendoj se nuk mund të ndryshohen rregullat në mes të lojës, kryetaria e tha çdo këshilltar që do të informohet mund të marrë pjesë në komisione, nuk kemi pse ndryshojmë rregullat tani, çdo këshilltar është i lirë të marrë pjesë në çdo komision, komisioni i financave është ai që është mbledhur rregullisht, unë gjykoj që të vazhdojmë siç jemi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush e do fjalën tjetër?

Këshilltar D.Osmani: Bëhet fjalë për mandatin tim këtu ta mbaroj fjalën, e para nuk po ndryshojmë as rregulla, këto nuk janë rregulla thjesht po diskutojmë mandatet e dy këshilltarëve dhe këtë nuk e kemi ne në dorë ata janë larguar për arsyt e tyre. Nuk ka qënë në dëshirën time të jap dorëheqje por ka qënë në dëshirën time që zonja që sapo mori mandatin të jetë në këtë komision meqënëse është dhe eksperte shumë e vlerësuar e Partisë Demoratikë, e dyta si do i vendosim ne këshilltarët në komisione secili ka të drejtën e tij, nuk mund t'ja imponosh opozitës. Ka qënë mendimi juaj që nuk e doni në atë komision znj.Qeleshi, ndoshta ju personalisht jo, mos e diskutojmë më tutje, më vjen keq për këtë sepse ne jemi në një qytet dimë të bëjmë dhe politikë, dimë të jemi dhe qytetarë dhe që të vazhdojmë të jemi qytetarë duhet të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, të vazhdojmë siç kemi bërë këto dy vjet sepse nuk është në nderin të asnjë këshilltari që të diskutojmë këtë mandate, në komision ne do kemi znj.Mirela ashtu siç kemi dhe znj.Alketa dhe nuk ja vlen të diskutojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për propozimin tuaj, fjala për z.Bode.

Këshilltar I.Bode: Faleminderit për fjalën, mesa me kujtohet kur kemi krijuar komisionet emrat që na takonin ne si opozitë i kemi propozuar ne në bazë të raportit këto komisione janë miratuar. Tani opozitës i lind e drejta të zvëndësojë dikë nga këto anëtarë të komisionit qoftë edhe për mos dashje të dikujt për ta ushtruar atë detyrë. Meqënëse tek këto dy komisione anëtarët që po zvëndësohen janë pjesë e opozitës, unë kam një propozim të thjeshtë në komisionin e financave të zvëndësohet z.Osmanime znj.Qeleshi dhe në komisionet e sigurisë publike, emergjencave civile të zvëndësohet z.Skënderasi me z.Osmani.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me rastin në fjalë, në respekt të rregullores kjo procedurë kalon në votim dhe ne jemi dakort, por para se të kalojmë në votim ne duhet të propozojmë, ne duhet të respektojmë kriterin se komisionet janë të ndara me numër të caktuar sa i takojnë opozitës dhe mazhorancës dhe nuk mund të përdoret si justifikim që nuk bëjmë dot ndryshime sepse duhet hedhur në votim, këtu ndryshimet duhen bërë patjetër sepse duhet ruajtur raporti, nëse ne nuk ruajmë raportin pozitë-opozitë kemi shkelur rregulloren e Këshillit Bashkiak. A është dakort Këshilli të shkelen këto rregulla?

Unë besoj që jo, atëherë duhen marrë në konsideratë propozimet e opozitës për të formatuar komisionet brenda parametrave që lejon rregullorja, besoj se dhe znj.sekretare që na dha përgjigjen bie dakort me këtë gjë sepse nuk mund të shkelë rregulloren.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Në momentin e parë kur nga KQZ erdhën vendimet për caktimin e këtyre këshilltarëve sipas listës shumë emërore të së njëjtës parti, bazuar në shkresat, tek ligji, tek rregullorja, atje tek vendimi për z.Sanjel thuhej se zvëndëson këshilltarin e larguar Fidel Kreka, pastaj sesi votojnë këta këshilltarë dhe si pozicionohen unë nuk e di. Unë kam rregulloren e cila shprehimisht më thotë se këshilltari i ri i cili zvëndëson një këshilltar të larguar është pjesë e komisioneve të Këshillit ku ka qënë këshilltari i zvëndësuar dhe unë kam zbatuar këtë rregullore. Me këtë që kërkon ju doni të riformatoni gjithë komisionet e Këshillit.

Këshilltar E.Bregu: Jo të gjitha propozimet që bëmë vetëm.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Ju jeni duke aluduar se ne po mbajmë një komision vetëm të një partie politike, ndërkohë që zotëria nuk ka erdhur si kandidat i listës shumë emërore të Partisë Socialiste.

Këshilltar E.Bregu: Të lutem ai është fakt publik që ai është pozicionuar në Partinë Socialiste, duke pasur parasysh faktin publik ne ngreme këtë aludim.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Ju keni të drejtë të bëni propozim dhe propozimet tuaja të hidhen në votim dhe është Këshilli ai që vendos.

Këshilltar E.Bregu: Prandaj po i tërheq vëmendje Këshillit që të ruajë balancat, shumë dakort jam të hidhet në votim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Petri ka kërkuar fjalën.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare më lejo që dhe unë të uroj dy kolegët e rinj dhe t'jnu uroj sukses, unë mbështes propozimin e bërë nga z.Osmani dhe nuk shoh ndonjë vend për të pasur frikë për votimin e këtyre propozimeve, nuk kemi pse bëhemi me katolikë se Papa këtu, a thua se ne luftën e madhe e kemi bërë në komisione, ne e dimë të gjithë se pjesa më e madhe nuk vjen, ose kur vjen vijnë 5 minuta dhe ikin, por hajde t'i qëndrojmë rregullores, në momentin që synojmë të kemi demokraci, demokracia alfën dhe omegën ka check balance dhe nuk mund të kesh check balance në një komision ku gjithë anëtarët e këtij komisioni janë të një grupimi politik, besoj se edhe nënteksti i kolegut të ri z.Skënderasi ishte më takon mua të votoj për kë të dua, që unë nuk jam me atë çka më kanë votuar votuesit që ishte Koalicioni Bashkë Fitojmë që duhet pozicionuar me grupin opozitar por është zgjedhja e tij dhe ne nuk e gjykojmë. Ne jemi këtu që Këshilli të ketë sa më shumë cilësisht check balance dhe ju lutem merreni në konsideratë këto propozime sepse janë në të mirë të Këshillit.

Këshilltar E.Fejzullah: Edhe unë ju uroj mirë se ardhjen kolegëve dhe t'ja kalojnë sa më mirë në këtë sipërmarrjen e tyre. Ne kemi pasur goxha probleme dhe ju vetë e keni ngritur si problematikë për sa i përket pjesëmarrjes të anëtarëve, kështu që mbase do ishte e udhës të shikoheshin dhe njëherë gjithë komisionet në bazë të pjesëmarrjes, angazhimeve që mbase kanë marrë përsipër ta bëjnë por tani nuk kanë mundësi dhe nuk e shoh si problematikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.Fejzullah për mendimin tuaj, unë i propozoj Këshillit të hedhim në votim propozimin e grupit opozitar për vendosjen e znj.Mirela Qeleshi në komisionin e financave.

Këshilltar D.Osmani: Duhet të hedhësh njëherë dorëheqjen time në votim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ke të drejtë, kush është dakort që z.Osmani të largohet nga komisioni i financave?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 13

Vota KUNDËR 16

Vota ABSTENIM 3

Këshilltar D.Osmani: Tani se po e bëni shumë qesharake nuk mund të votohet një dorëheqje, dorëheqjen e jap unë dhe ju e miratoni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë nuk e miratoj dot, duhet ta hedh në votim.

Këshilltar E.Bregu: Znj.Kryetare dorëheqja është e parevokueshme, thjesht konstatohet, nuk miratohet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse z.Osmani është tërhequr nga komisioni i financave, atëherë, kush është dakort, të jetë pjesë e komisionit të financave?

Këshilltar E.Bregu: Në momentin që shkelet rregullorja duhet parë komisioni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më ler të mbaroj këtë proces.

Këshilltar D.Osmani: Tani se po e bëni shumë qesharake.

Këshilltar E.Bregu: Nuk ju ka erdhur urdhëri për këtë çështje nuk dinë si të votojnë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem të votoni.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 13

Vota KUNDËR 16

Vota ABSTENIM 3

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk miratohet. A ka propozim tjetër?

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka mundësi të flasësh me qetësi dhe ulu në vend, nuk e drejtoni ju mbledhjen. A ka propozim tjetër nga ana e opozitës?

Sekretaria ju lutem të përcaktojë nëse kjo procedurë është e rregullt.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Procedurën e ka përcaktuar rregullorja, hidh në votim sipas rregullores, këshilltarët e rinj që zvendëson këshilltarin e larguar.

Këshilltar E.Bregu: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe ne do ju propozojmë të vendosni një emër tjetër.

Këshilltar D.Osmani: Pse kush jeni ju?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk po flas në emrin tim personal.

Këshilltar D.Osmani: Nuk komandon dot tin ë grupin tonë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komandimin e emrave e keni bërë ju jo unë.

Këshilltar D.Osmani: Komisioni i financave ka 5 anëtarë, raporti pozitiv- opozitë është 3 me 2, me dorëheqjen time u bë 3 me 1, më takon dhe një anëtar mua, nuk e vendosni ju. Dhe për ata që votojnë kundër kolegut turp.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Dorëzoni dorëheqjen me shkrim.

Këshilltar D.Osmani: Kjo është tjetër gjë, por nuk e zgjidhni ju opozitën deri dje mund ta zgjidhni sot ka disa ata pak që jemi po jemi nuk mund të bëni si të doni.

Këshilltar E.Bregu: Anëtarët e rinj nuk mund të cakton në komisione nëse nuk kanë pranuar të kandidojnë.

Këshilltar D.Osmani: Turp të keni që bëni nga këto.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Faleminderit, dorëzoheni dorëheqjen me shkrim, dorëheqja juaj nuk ishte parashikuar në këtë mbledhje.

Këshilltar D.Osmani: Nuk mund të votosh kundër 1 kolegu është turp.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: E kërkuat ju.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem ruani qetësinë.

Këshilltar D.Osmani: Qetësia deri në një pikë ruhet në momentin që talleni me mandatet e opozitës nuk ruhet qetësia. Çfarë ju duket ju që të votoni kundër një kolegu tuaj?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk e di cila është arsyeja që me kaq ngulm e kërkon dhe hamëndesoni gjëra të tjera.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Tollkuçi ka kërkuar fjalën, më pas znj.Taho.

Këshilltar P.Tollkuçi: E nderuar kryetare, të nderuar kolegë, ju e dini shumë mirë që edhe në rastet kur kolegu paraardhës ka dhënë dorëheqjen këtu është miratuar me votë.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk mund të flasësh më shumë se njëherë për të njëjtën çështje.

Këshilltar D.Osmani: Nuk ma heq dot ti fjalën, as nga salla nuk me nxjerr dot.

Këshilltar P.Tollkuçi: Nuk e di pse duhet të bëjmë kaq debat, kur rregullat janë të shkruara dhe sekretaria e këshillit e tha drejt se këshilltari i ri merr postin e këshilltarit të larguar në komisione, tani herën e parë ngremë zërin se jo ky person është me ju. Po personi që është me ju pse duhet të ngrerë vendin e një personi që jeni ju, nuk e kuptoj këtë pjesë sepse janë dy standarte, këtej thoni nuk duam ta ndryshojmë lojën në mes të lojës tani doni ta ndryshoni, unë mendoj se këtu flasim me votë.

Këshilltare A.Taho: Më vjen keq që kjo mbledhje po vazhdon me këto tone zëri, ku kryetari i komisionit përmendi pak më parë që ne anëtarët i kemi caktuar duke folur me njeri-tjetrin kështu që z.Osmani hajd ulemi e bisedojmë sepse këtu flasim me rregulla, na keni kërkuar sot të votojmë dorëheqjen mos e votojmë, të votojmë këtë apo atë, na lini të zbatojmë rregulloren sepse kjo çështja po na pengon për

materialet e tjera të cilat janë shumë të rëndësishme, kështu që ju kërkoj ju znj.kryetare t'i jepni zgjidhje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për z.Bode.

Këshilltar I.Bode: Duke qënë se komisioni mbetet me 4 anëtarë, dorëheqja e një anëtari komisioni duke qënë se u dha në mbledhje është zyrtare nuk ka nevojë të bëhet as me shkrim, as me vulë, e ka kërkuar në mbledhje dhe komisioni është me 4 anëtarë dhe bie gjithë komisioni sepse duhet të jetë me 5 anëtarë, 2 opozitë 3 mazhorancë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo nuk bie gjithë komisioni sepse nuk ka si bie.

Këshilltar I.Bode: Nuk mund të funksionojë me 4 anëtarë.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Komisioni funksionon edhe me 3 anëtarë.

Këshilltar D.Osmani: Znj.Sekretare neni 42 për mbarëvajtjen e komisioneve nuk ta lejon që ta bësh me 4, sepse komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, 3 mazhoranca dhe 2 opozita.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Do e plotësojmë me dikë tjetër.

Këshilltar D.Osmani: Nuk mund të votoni kundër kolegut, megjithatë mirë bëtë.

Këshilltar K.Pllaha: Ndjesë që po ndërhy sepse unë jam jashtë dy grupeve politike po meqënëse po përmendet rregullorja doja t'ja u lexoja dhe neni 33 i rregullores për ngritjen dhe përbërjen e komisionit të përhershëm thotë Këshilli mund të ndryshojë përbërjen e komisionit të përhershëm duke ruajtur përpjestimin e grupeve, për ndryshimin e numrit dhe përbërjes të komisioneve synohet arritja e mirëkuptimit mes grupeve politike të këshilltarëve, votimi bëhet pas marrëveshjes është e vërtet pika 10 ku thotë këshilltari i ri zvëndëson këshilltarin e larguar në komisione, por nuk është taksative mund të arrihet me marrëveshje edhe numri nga 5 mund të bëhet edhe 7 nëse dakortësohemi.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Të zbatojmë rregulloren pikën 10, të hedhim në votim sipas rregullores dhe ftoj konferencën e kryetarëve në mbledhjen e radhës të mbledhet dhe të vendosin.

Këshilltar I.Bode: Numri minimal i anëtarëve të komisionit duhet të jetë 5, sepse ma ndërpretë 4 veta fjalën.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: 5 do jetë derisa të plotësohet do rrijë me 4.

Këshilltar I.Bode: Numri minimal i anëtarëve të komisionit duhet të jetë 5, pastaj sesa duhen nga këta 5 sesa mblidhen është tjetër gjë, aktualisht komisioni është me 4 anëtarë bën rënien, në momentin që mblidhet komisioni për 1 çështje nevojitet shumica e komisionit pra nga 5 nevojiten 3 por si numër anëtarësh duhet të ketë5, ai ka 4 le të më ndihmojë drejtoresha juridike nëse e kam gabim, ky komision aktualisht ka 4 dhe nuk mund të funksionojë si komision.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Propozimi është të zbatojmë rregulloren të zvëndësojnë këshilltarët e rinja ata të larguar dhe herës tjetër mblidhet konferenca e kryetarëve dhe të rishikojë komisionet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ky është propozimi që do bëja dhe unë sot t'i lemë këshilltarët e rinj në këto komisione edhe do mblidhen konferenca e kryetarëve të vendosin për komisionet që duan ndryshimet.

Këshilltar E.Bregu: Më fal mund ta marr fjalën sepse mu ndërpre disa herë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Këshilltar E.Bregu: Referuar debateve, duke pasur parasysh fjalën e sekretares dhe kryetares të Partisë Socialiste znj. Anxhela , po ju sqaroj diçka votimi bëhet për të ndjekur procedurën, nuk bëhet sepse ke dëshirë ti të vihet ky apo ai person. Vërtet hidhet në votim por hidhet për të parë janë ndjekur standartet, nuk mund të thuash ti nuk më pëlqen mua Mirela, më pëlqen ai tjetri kur atë e ka sjellë grupi që përfaqëson, ndaj mbledhjen mendjen dhe mos votoni sipas dëshirave, respektoni ligjin. Së dyti u bë efektive dorëheqja e z.Devis Osmani sepse ne hodhëm në votim kandidaturën tjetër, ky është fakt nuk mund të kërkohet nga Devisi jepe dorëheqjen me shkrim, kjo është zyrtare dorëheqja u dha quhet e pranuar komisioni është me 4 aktualisht dhe ky komision nuk funksionon pasi duhet në strukturë me 5, në mbledhje vërtet funksionon me 3 sepse është shumica por kur struktura është me 5, nëse struktura është me 4 komisioni është i paligjshëm, ndaj ju bëj thirrje sidomos specialistëve ligjorë të Këshillit Bashkiak që të reflektojnë me veten dhe të marrin vendimet e duhura.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë po e përsëris, meqënëse këshilltarët e rinj zvëndësojnë këshilltarët e larguar në këtë mbledhje të qëndrojnë në këto komisione edhe z.Osmani dhe javës që vjen të mbledhet konferenca e kryetarëve dhe të vendosin për ndryshimet në ato komisionbe që propozon opozita.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Ne sot do zbatojmë rregulloren, nuk e kemi shkelur, në mbledhjen e sotme këshilltarët të qëndrojnë tek komisionet që kanë qënë këshilltarët e larguar më pas të mbledhet konferenca e kryetarëve dhe të caktojë.

Këshilltar D.Osmani: Edhe njëherë se më vjen keq se janë edhe këshilltarët e rinj dhe duket sikur po merremi me ta, komisionet janë në përbërje 3me 2 dhe unë po ju them që komisioni i cili është z.Skënderasi nuk përfaqëson forcën politike nga ka marrë mandatin, Sanjeli le të rrijë atje nëse ju nuk doni ta vendosni në vend tjetër sepse është detyra juaj si do e bëni, ne atë vend e duam do vemë tjetër person nga këshilltarët. E dyta për pjesën e komisionit të financave po iki unë dhe propozva znj.Qeleshi.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: (Nuk ka audio.)

Këshilltar D.Osmani: Të lutem të mbaroj fjalën, në respektin tim sepse jam diskutuar unë me kryetaren, nuk e drejton ti mbledhjen sepse ti je shumë politikisht e ndikuar.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Më fal por në funksion të procedurës po ndërhy, sepse këtej më drejtohesh mua znj.sekretare pastaj thua po flas me kryetaren.

Këshilltar D.Osmani: Të lutem të mbaroj fjalën, sepse kemi 1 orë që po bëjmë debate që për mendimin tim nuk duhet t'i bënim, rregulli e ka përcaktuar qartë 3 me 2 as po kërkojmë më shumë thjesht propozuam në emër, ju apo gjithë Këshillit nuk i takon të analizojë emrat ju keni përfaqësuesit tuaj, ne tanët tjetër gjë e pranon apo jo, vendimin se kë do vemë ne na takon ne dhe ishte gabim shumë i rëndë të votosh kundër. Dy emra na takojnë ne nuk ka pse mbledhet konferenca e kryetarëve, sepse çfarë do diskutojmë, këtë që diskutojmë edhe tani, nuk ka pse bëjmë as pazare as diskutime, na takon 1 emër i qëndrojmë atij emri dhe është e drejta jonë nuk ken ipse vendosni ju.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë sepse ju dëgjova me vëmendje, në rregullore këshilltari i ri në komisione zë vendin e këshilltarit të larguar, le të mbledhet konferenca e kryetarëve të propozohen emra

të tjera dhe për ato komisione që duan të riformatohen të vendoset si do veprohet. Eva të lutem elxo rregulloren ku pozicionohen këshilltarët e rinj.

Këshilltar I.Bode: Znj.Kryetare ju lutem se jeni gabim, komisioni i financave është me 4 anëtarë pse na detyroni të thërresim. Më vjen keq zonjë që thoni nuk ju jap fjalën , jeni para faktit që ju ka rënë komisioni.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Komisioni me rregullore nuk ka rënë. Në pikën 11 të nenit 33,

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos flisni pa rradhë, nëse doni të bëni zhurmuesin bëjeni.

Këshilltar D.Osmani: Është e drejta jonë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Znj.Sekretare ju lutem lexoni emrat ku pozicionohen këshilltarët e rinj në komisione.

Këshilltar D.Osmani: Ju lutem sepse po gaboni na keni lënë pa përfaqësim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të mbledhet konferenca e kryetarëve dhe të vendoset për propozimet e tjera, nëse do ishit jurist do e besoja këtë që sapo thatë.

Këshilltar D.Osmani: Nuk ka lidhje përjursit por është keq përfaqësim, na takon të përfaqësohemi.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Në zbatim të rregullores të Këshillit bashkiak Korçë seksioni 2, neni 33 pika 10 znj.Mirela Qelesi e cila ka zvëndësuar këshilltaren e larguar znj.Ismeralda Seidolli është pjesë e komisionit të ligjeve, çështjeve ligjore dhe administrative dhe pasurive të bashkisë, komisionit të buqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes të diversitetit dhe komisioni pët titujt e nderit. Z.Sanjel Skënderasi i cili ka zvëndësuar këshilltarin e larguar Fidel Kreka do jetë pjesë e komisionit të emergjencave dhe rehabilitimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort?

Këshilltar D.Osmani: Ju lutem për procedurë grupi jonë nuk merr pjesë në votim, numëro pak votat ju lutem.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25 SHTATOR 2025”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka nga këshilltarët e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR PËR PERIUDHËN 1-30 SHTATOR 2025”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare A.Taho: Për muajin shtator janë 44 familje që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike, po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 19 familje dhe 15 familje përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, i kërkojmë Këshillit miratimin e këtij materiali.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje?

Këshilltare M.Qeleshi: Fondi sipas materialit është 225 890 lekë, si 6 % e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike nga sistemi i pikëzimit. Kjo është dhënë për 44 familje, 19 familje komepnsim energjie dhe 15 familje, gjithë ky fond është shpenzuar sepse e keni ndarë në 3 pjesë?

Këshilltare A.Taho: Po më drejtoheni mua por unë jam komisioni nuk e di.

Këshilltare M.Qeleshi: Më fal nuk di kujt t'i drejtohem.

Ekzekutivi: Besoj se po.

Këshilltare M.Qeleshi: Tani besoj se po me shifra finance nuk më duket normale kjo fjalë, më fal. Në rast se mblidhni shifrat të del ajo vlerë, e konsumoni të gjithën dhe nëse jo, pse?

Diferenca që ngelet mund të përdoret ose për 3 familje për energjinë, ose për 1 familje nga këto të kriteret e tjera.

Këshilltare A.Taho: Familjet që kanë plotësuar kriteret për këtë muaj janë 44 dhe nuk di të ta them nëse është gjithë fondi i shpenzuar.

Drejtorja e Fianancës V.Ziko: Fondi 6% është fondi i kushtëzuar i cili është pjesë e fondit të ndihmës ekonomike që vjen nga buxheti i shteti vjen në total zakonisht çdo dy muaj. Pra nga 225 që bëjnë përlllogaritjet do paguhen nga ky fond vetëm 172 dhe pjesa tjetër mbetet në buxhet, ndërsa 49 është pjesë e buxhetit që ne kemi miratuar në Këshill nga fondet tona, kaq është shpjegimi.

Këshilltare M.Qeleshi: Tani pse nuk harxhohet gjithë vlera sepse vlera që ngelet mund të përdoret për 3 familje.

Drejtoria e Fianancës V.Ziko: Kaq kanë konstatuar këta.

Këshilltare M.Qeleshi: Atëherë mos thoni për muajin shtator është në dispozicion ky fond, ka një anormali në të shprehur sepse jo gjithë vlera përdoret duhet sqaruar në material. E dyta mund të vendosni disa pika, prejsa kush e ka hartuar materialin mos e marrim kështu në vijë lineare meqënëse nuk isha në komision.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka nga këshilltarët për gabimet autografike, e hedhim në votim, kush është dakort?

Këshilltare A.Taho: Unë do doja që znj.Qeleshi të na kishte ndjekur, numri i familjeve ndryshon muaj për muaj prandaj ne themi për muajin shtator. Fondi është por varet sa i plotësojnë kriteret.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 30 këshilltarë, 30 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 150.000 LEKË PËR QËNDRËN REZIDENCIALE TË ZHVILLIMIT”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është një donacion nga Këshilli i qarkut besoj se nuk ka asnjë problem apo diskutim. Kush është dakort për këtë donacion?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 33 këshilltarë, 32 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

“PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR 8, DATË 30.01.2025 “PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2025”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni në dijeninë time nuk është mbledhur, ju lutem ekzekutivi një përmbledhje të shkurtër.

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Në muajin shkurt është miratuar plani i pranimit në shërbimin civil për vitin 2025. Përveç pozicioneve që janë në nivele ekzekutiv të cilat miratohen nëpërmjet një procedure konkursi, ligji parashikon edhe një përjashtim nga rregulli që pozicionet të cilat janë të nivelit të ulët drejtues apo niveli i mesëm drejtues pasi të jenë ezauruar të gjitha fazat e konkursit dhe nëse nuk plotësohen me procedurën e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë mund të bëhen nëpërmjet pranimit nga jashtë shërbimit civilit, kjo është në masën 20 %. Në planin e muajit shkurt kemi pasur 4 pozicione, drejtori i drejtorisë të turizmit, drejtor i drejtorisë të marrëdhënive me publikun, përgjegjësi i sektorit të turizmit dhe përgjegjësi i sektorit të kontrollit për zhvillimin e tokës. Sygjerimi jonë është të hiqet nga rekurtimi të hiqet jashtë shërbimit civil pozicioni drejtor i drejtorisë të marrëdhënive me publikun dhe në vend të tij të shtohet përgjegjës sektori për publikimet, gjithë pjesa tjetër e planit në shërbimin civil mbetet e pa ndryshuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Dua të pyes ekzekutivin, sepse nga fjala e koleges na u tha se vetëm 20 % vijnë nga shërbimi civil dhe nënkuptoj se pjesa tjetër vijnë me konkurs pra 80 %, e vërteton këtë?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Nga 100 % pozicione të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues që mund të jenë bosh vetëm 20 % e tyre bëhem me konkurs por me pranim nga jashtë shërbimit civil, domethënë pozicion që janë të nivelit ekzekutiv pranohen të gjitha me konkurs, nuk ka asnjë pozicion që plotësohet pa konkurs. Pozicionet që janë të nivelit të ulët drejtues ose të mesëm drejtues, pasi të jenë ezauruar procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë dhe nuk plotësohen pranohen nga jashtë shërbimit civil por me konkurs.

Këshilltar L.Petri: Pra mund ta marrim që për këtë rast nuk është ezauruar konkursi për hapat e parë proceduriale, pse nuk është bërë thirrje për këto vende?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Pozicionet gjykohen rast pas rasti kush duhet të plotësohet dhe kush jo, në këto momente pozicioni i përgjegjës është gjykuar të plotësohet pasi aktualisht është bosh. Ne do ezaurojmë të dyja fazat dhe lëvizje paralele dhe ngritjes në detyrë dhe nëse nuk plotësohet Këshilli na lejon që ta plotësojmë nga jashtë shërbimit civil.

Këshilltar L.Petri: Pra po thoni se dhe pozicioni i drejtorisë të turizmit është bërë me konkurs?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Këto 4 vendet e përmendura asnjëri nuk është plotësuar pasi nuk janë shpallur procedurat e konkursit.

Këshilltar K.Pllaha: E kuptova procedurën por nuk kuptova arsyen pse, pra ju keni ndërmend të hapni këtë vend pune dhe ju po parashikoni se nuk do keni kërkesa në këto lëvizje paralele dhe prandaj po paraprijmë me vendim të Këshillit Bashkiak të marrim dikë jashtë shërbimit civil?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Keni miratuar në shkurt planin e punësimit dhe ligji e parashikon se ne, Bashkia ose çdo institucion që i nënshtrohet ligjit për statusin e nënpunësit mund të parashikojë në masën 20 % nga jashtë shërbimit civil dhe ne po themi në rast se nuk plotësohet në këtë mënyrë, ta marrim nga jashtë.

Këshilltar K.Pllaha: Pse pikërisht po ndryshon ky pozicion, sepse ne kemi miratuar 4 pozicione me këtë mënyrë.

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Sepse në këtë fazë kemi vendosur të shpallim pozicionin e përgjegjësit dhe në rast se nuk plotësohet do e pranojmë nga jashtë.

Këshilltar K.Pllaha: Pse ta kërkojmë nga jashtë, shikojeni njëherë me të brendshmit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kështu është procedura.

Këshilltar K.Pllaha: Mund të bëj një pyetje ndoshta nuk lidhet drejt për drejt me këtë por pati para disa muajsh një thirrje publike për personat që kishin interes për të punuar në Bashki, unë kam kuriozitetin sa thirrje ka pasur dhe a kalojnë këta nëpërmjet një konkursi sepse thirrja ishte e hapur pa pozicion?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ka pasur diku rreth 170 e ca aplikime nëpërmjet kësaj thirrje, kemi zhvilluar disa intervista kryesisht financa, drejtoria e kontrollit të territorit, inspektoriati i ndërtimit dhe janë punësuar 5 veta. Në pjesën e strukturës të Bashkisë, përveç pjesës të shërbimit civil që janë shumica kemi dhe një sektor intershipi ku këta punësohen me kontrata pune me afate të shkurtra 3-mujore dhe nëse hapet një vend më pas dhe këta kanë të drejtë të konkurojnë.

Këshilltar K.Pllaha: Mund të bëj një pyetje?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem Klajdi mos e bëni pyetje përgjigje.

Këshilltar K.Pllaha: Unë dua të di personat që rekurtohen në funksion intershipi, a nuk kanë detyrim që t'i nënshtrohen një konkursi sepse me aq informacion sa kam unë edhe intershipet i nënshtrohen konkursit. E dyta nëse këta persona bëjnë kalim në shërbimin civil quhet si lëvizje paralele?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Jo.

Këshilltar K.Pllaha: Po për konkurs?

Drejtroria Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Ne ligji na lejon të bëjmë konkurs për shërbimin civil, për këtë të intershipit nuk e di ku bazohesh që bëhen me konkurs.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, nëse nuk ka pyetje të tjera e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 6

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 29 këshilltarë, 23 pro, 6 kundër, 0 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E VENDOSJES TË NJË MONUMENTI PËRKUJTIMOR NË FSHATIN VOSKOPOJË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem, kush do flasë?

Këshilltar P.Bello: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka nga këshilltarët ndonjë pyetje lidhur me këtë çështje?

Këshilltar L.Petri: E falenderoj profesorin për këtë parashtrim është gjithmonë një gosti për veshët kur ai flet në këtë mënyrë. Vetëm se tema e rendit të ditës nuk ishte çfarë është familja Sina por një person i cili ka lidhje me Ambasadën Hungareze dhe i është propozuar ekzekutivit të vendoset një përmendore në fshatin e Voskopojës sepse sot nuk është më ai civilizim në Voskopojë. Ne si komision e vlerësuar, vlerësojmë edhe historikun e asaj familje sepse është një lloj krenarie dhe sa më shumë t'i shplurosim këto vlerë aq më mirë është për ne dhe brezat e ardhshëm. Le të fokusohemi pak se çfarë po ndodh, këtu është kërkuar një përmendore dhe ne kur u mbledhëm në komision morëm në telefon kryetarin e fshatit dhe ai na tha se nuk ishte në dijeni. Tani këto janë disa gjëra ku ne nuk mund t'i gëlltitim lehtë sepse dhe kur u fol për z.Zai Fundo ne nuk mund të flasim kundër të ndjerit, por mënyra si u veprua, mënyra si u veprua edhe me vendosjen e kullës, ka një neglizhim dhe mos pleqërim me njerëzit që nuk e di nga buron kjo arrogancë dhe ne si komision e deklarojmë se nuk jemi dakort për këtë arsye, por ne e vlerësuar si një vlerë të shtuar, në parim jemi të vendoset kjo përmendore por dhamë sygjërimet tona në 3 pika. Pika e parë ka të bëjë me shkrimin sepse përmendorja në fjalë ka një stemë është shkruar diçka në hungarisht por nuk thuhet asgjë për familjen Sina, po ta shohësh me syrin e një ushërfyesi apo vizitori që jo domosdoshmërisht di hungarisht apo shqip, ne sygjëruam si komision të thuhej në mënyrë të përmbledhur një sintezë se cila është vlera e kësaj familjeve. Po ashtu sygjëruam se i njëjti paragraf që ishte në hungarisht dhe në shqip të vendosej edhe në anglisht dhe për më tepër duhet të na i konfirmojë ekzekutivi por me një telefonatë që bëri kolegu me personin e kontaktit sepse është dhurim për fshatin kuptuam që ata e kishin printuar, kanë caktuar një mbledhje ku do vijë diplomati i Ambasadës që ne nuk jemi kundër, por të vendoset gjithçka dhe ne sot të na sillen në Këshill kjo as nuk haet as nuk pihet, kështu që ne e votojmë pro që të merren parasysh sygjërimet dhe herën tjetër të merren parasysh.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, para se t'ja jap fjalën drejtorit të urbanistikës një informacion, ju përmendet në fjalën tuaj se administratori i fshatit nuk është në dijeni, përkundrazi ne dje kemi qënë në Voskopojë kemi bërë një takim në kuadër të buxhetit dhe ne kemi mbajtur dhe një procesverbal në kuadër të atij takimi dhe ata janë shprehur të dakortësuar për vendosjen e bustit. Madje na u tha se është një dhurim dhe drejtorja e urbanistikës ka diskutuar me ta edhe vendin ku do vendoset.

Drejtorja e Urbanistikës N.Hoxha: Administratori është në dijeni sepse takimet që kemi bërë kanë qënë në prani të administratorit. Të treja pikat janë marrë parasysh nuk është shtypur akoma shkrimi por do bëhet pas mbledhjes sepse duhet të merrej miratimi, të treja gjuhët do jenë të pasqyruar në pllakë do ketë edhe një përmbledhje të dinastisë Sina, të treja pikat janë plotësuar.

Këshilltare S.Dinellari: Në kuadër të shkrimit ishte edhe një gabim drejt shkrimor, është rregulluar?

Drejtoria e Urbanistikës N.Hoxha: Po.

Këshilltar K.Pllaha: Znj.Kryetare kisha një diçka, meqënëse po mundohemi të sjellim ato vlerat e Voskopojës dhe më vjen mirë të kemi një vëmendje tek ky fshat që dikur ka pasur edhe një histori të lavdishme siç e përmendi dhe profesori dhe ndër to është dhe Akademia dhe Shtypshkronja e saj. Unë kisha një sygjërim për ekzekutivin këto godina të nxirren në pah ku kanë qënë, mbase dhe të ristaurohen dhe të bëhen të aksesueshme për vizitorët, sepse në dijeninë time nuk është e mundur të aksesohet godina ku ka qënë shtypshkronja e Voskopojës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 31 këshilltarë, 31 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS TË ZGJEDHJES TË KRYETARIT TË FSHATIT VITHKUQ, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VITHKUQ”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni në dijeninë time nuk është mbledhur, Ju lutem sekretaria.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Jemi njoftuar nga njësia administrative Vithkuq për shkak se kryetari i fshatit Vithkuq i zgjedhur nga kryesia nuk e ka ushtruar për pak kohë detyrën, anëtarët e kryesisë e kanë shkarkuar nga pozicioni i kryetarit të fshatit Vithkuq, jemi vënë në dijeni. Në zbatim të rregullores që kemi, kemi ngritur me vendim disa komisione që kanë mbikëqyrur zgjedhen e antarësisë dhe kryetarëve të fshatrave në momentin kur u mandatua Këshilli. Në këto kushte do marrim një vendim për vazhdimin e procedurave dhe po i njëjti komision i cili është zgjedhur para pak kohësh për mbikëqyrjen e zgjedhjeve do caktojë një ditë për të mbikëqyrur këtë si process dhe për transparencë.

Këshilltar K.Pllaha: Ka një gabim tek data.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Po ka një gabim do korrigojohet, datën do ja u lemë anëtarëve të komisionit bashkë me anëtarët e kryesisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 31 këshilltarë, 31 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju është shpërndarë raporti i monitorimit të periudhës janar-gusht, e cila është informacion për këshilltarët. Kalojmë tek kërkesa-ankesa kemi 3 të depozituara në sekretari, njëra i drejtohet Bashkisë Korçë dhe për dijeni të Këshillit të Qarkut dhe Këshillit të Bashkisë, kërkesë për shtrimin me asfalt dhe përfundimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në rrugën “Marko Boçari” dhe “Dhimitër Zografi” në lagjen 4 Korçë mos hy në detaje ta lexoj gjithë kërkesën por thelbi ky është. Ne ende nuk i kemi administruar kërkesat për investime si Këshill sepse Bashkia e ka bërë dëgjesa publike në gjithë njësitë administrative edhe në qytet dhe besoj se e ka administruar edhe këtë kërkesë për investime të banorëve të kësaj lagje ne do jemi në terren dhe kalendari është shpërndarë dhe do ju lutem gjithë këshilltarëve të jenë prezent sepse detyrimore e ka dhe komisioni i financave për ta ndjekur këtë konsultim., ne do bëjmë një raport për ekzekutivin me gjitha kërkesat. Kërkesë tjetër drejtuar kryetarit të Bashkisë vjen nga z.Leonard bejko si përfaqësues i shoqatës të të përndjekurve Korçë, me anë të kësaj kërkesë dua të paraqes propozimin tim për të emëruar dy rrugë të qytetit tonë me emër Dervish Bejko dhe Ymer Merdani në nderim të këtyre dy figurave heroike të qytetit tonë, kjo do konsultohet me ekzekutivin pasi ne nuk e dimë nëse ka ende rrugë të cilat duhet të titullohen dhe më pas pasi të marrim një informacion nga ekzekutivi, do ju njoftojmë. Kërkesa tjetër vjen nga znj.Rabian Dyli. Unë e nënshkruara Rabian Dyli do bëja këtë kërkesë lidhur me komisionin që do ngrihet nga Këshilli i Bashkisë për banesat sociale, ju e dini që mbledhjen e kaluar zonja Rabian u informua për këtë sepse u dha urdhër nga kryetari i Bashkisë për tu ngritur ky komision dhe po ja bëj me dije znj.Rabian që ne komisionet i kemi të ndërtuara nga opozita dhe pozita ne na i përcakton rregullorja që komisionet të ngrihen në këtë mënyrë dhe këto të tjerat të vijnë kur të doni. Unë ja u kam thënë edhe publikisht edhe veçmas që ne dhe kryetari i Bashkisë e ka në përparësi zgjidhjen e çështjes tuaj, faleminderit.

Qytetaria: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do të lutesha kur ke duruar kaq kohë, duro edhe pak kohë për t’i dhënë zgjidhje ashtu sikurse duhet, të jesh e bindur që edhe kryetari edhe ne si Këshill jemi pranë teje.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Duke qënë se kur nisi mbledhja ishte pak me tone të larta dua të sqaroj diçka në momentin kur krijohen vende bosh në komisione se çfarë thotë rregullorja. Të gjitha vendet bosh të anëtarëve të komisionit plotësohen brenda dy muajve. Komisioni i mandateve është përgjegjës për propozime për plotësimin e vendeve bosh duke garantuar barazinë gjinore, propozime të cilat miratohen në mbledhjen e Këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit edhe në vëmendje të këshilltarëve opozitarë, të kenë propozimet e duhura për këto komisione. Shihemi mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

